

Roli i Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit

Ministri i Drejtësisë, në rolin e Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit bashkërendon punën për hartimin e politikave dhe përgatitjen e akteve ligjore dhe nënligjore për parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit.

Koordinatori Kombëtar Kundër Korrupsionit është përgjegjës për kryerjen e verifikimit (hetimit administrativ) të denoncimeve/ankesave për praktika abuzive, korruptive apo arbitrare për zbatimin e ligjshmërisë, si dhe identifikimi i punonjësit e institucioneve, pjesë e Rrjetit të Koordinatorëve, të cilët, me veprime apo mosveprime, kanë kryer shkelje të akteve ligjore/nënligjore në fuqi, si dhe njëkohësisht zhvillimi i projekteve dhe i programeve në fushën e kundër korrupsionit, planifikimi, koordinimi e përcaktimi i instrumenteve të domosdoshme për implementimin e politikave të fushës kundër korrupsionit.

Buletini elektronik është një mjet i gjerë komunikimi që synon të informojë nëpërmjet pasqyrit të një përmbledhjeje të aktiviteteve kryesore të zhvilluara nga Ministria e Drejtësisë në fushën antikorrupsion, mbi baza mujore.

Aktivitetet përgjatë muajit Qershor, 2022

Zhvillohet konferenca e parë kombëtare “Antikorrupsioni”

13-15.06.2022. Zhvillohet për herë të parë në Tiranë, konferenca kombëtare antikorrupsion, në të cilën u bë publikimi i të parit raport kombëtar vetë-vlerësimi për antikorrupsionin, 2021: *Digjitalizimi si një mjet efektiv në luftën kundër korrupsionit*. Prioriteti kryesor i Qeverisë shqiptare, lufta kundër korrupsionit, bëri bashkë 21 institucione, të cilat nën drejtimin e sekretariatit teknik pranë Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit, bashkëpunuan për hartimin dhe shkrimin e një raporti kombëtar faktesh dhe të dhënash kundër korrupsionit. Progresi i arritur në zbatimin e masave antikorrupsion, rezultatet konkrete të garantimit të aksesit qytetar në fusha dhe sektorë shërbimesh, integriteti dhe transparenca e shërbimeve ndaj qytetarit, përdorimi i mekanizmave të ankesave dhe mjeteve digjitale në hetimin e korrupsionit, roli i medias dhe shoqërisë civile në perceptimin e korrupsionit, roli i shoqatave të biznesit në luftën kundër korrupsionit, ishin panelet e diskutimit që u zhvilluan gjatë këtyre tre-ditëve të konferencës. Një vend të veçantë në konferencë patën diskutimet e panelit 1: Reforma në drejtësi, ku u fol për progresin e reformës, procesin e vettingut, hetimi i korrupsionit dhe krimin të organizuar si dhe integriteti i gjyqtarit dhe prokurorit. Konferenca u zhvillua në prezencë të një publiku të gjerë, të pranishëm gjithashtu edhe përfaqësues të organizatave dhe partnerëve ndërkombëtare, ambasada dhe njësi të tjera. Të tre-ditët e konferencës u transmetuan direkt në kanalet e komunikimit të Kryeministrit, të Ministrit të Drejtësisë si dhe të anëtarëve të tjerë të qeverisë dhe mund të aksesohen në vijim gjithashtu.




Më shumë informacion mund të gjeni në link: <https://kryeministria.al/newsroom/konferenca-e-pare-kombetare-antikorrupsion-nje-bilanc-arritjesh-e-sfidash-ne-betejen-e-perditshme-kunder-korrupsionit/>

Shqipëri-Rumani, marrëdhënie shumë të mira politike, dhe në luftën kundër korrupsionit

28-29.06.2022. Ministri i Drejtësisë në cilësinë edhe të Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit, z.Manja, zhvilloi një takim pune në Rumani, me ministrin homolog, me zyrtarë të lartë të fushës antikorrupsion, zyrtarë të hetimit të krimin të organizuar dhe në Parlamentin e Rumanisë. Çështje të diskutimit në takime ishin ato të integritit evropian, një proces në pritje për tu çelur nga Shqipëria, çështje të fushës së drejtësisë me qëllim vendosjen e një partneriteti bashkëpunimi, fusha e bashkëpunimit dhe ndërveprimit të përbashkët në luftën kundër korrupsionit, lufta kundër krimin të organizuar dhe në të fushës së ligjënisë. Një takim i dedikuar në zyrat e Njësisë Antikorrupsion me kryeprokurorin z. Bologna, u zhvillua me qëllim shkëmbimin dhe ndarjen e eksperiencës për trajtimin e rasteve dhe të hetimeve antikorrupsion. Lufta kundër korrupsionit dhe bashkërendimi i veprimeve dhe nismave si dhe aplikimi i metodave operative hetimore kundër korrupsionin patën një interes të ndërsjellë mes strukturave të të dy vendeve.

Më shumë informacion mund të gjeni në link:

https://m.facebook.com/story.php?story_fbid=588022289345242&id=100044124279765



Shqipëria informon në GRECO për zhvillimet e fushës antikorrupsion

13-17.06.2022. Grupi i Shteteve Kundër Korrupsionit pranë Këshillit të Evropës (GRECO) zhvilloi punimet e seancës së 91-të plenare, në të cilën Shqipëria u përfaqësua nga kreu i Delegacionit qeveritar Zëvendësministri i Drejtësisë, znj. Pirdeni. Punimet e seancës plenare morrën në vlerësim raportet e vendeve të Irlandë, Hungari, Mali i Zi, Zvicër, Danimarkë, Belgjikë, Gjermani, Lihtenshtein, San Marino, Portugali, Gjeorgji e Itali, mbi ndjekjen dhe zbatimin prej tyre të rekomandimeve të dhëna më parë nga GRECO. Shqipëria ishte një prej vendeve vlerësues për raundin e III të vlerësimit, vlerësim plotësues për raportin e dytë të pajtueshmërisë së Danimarkës, vlerësime që u morën parasysh nga Sekretariati Teknik i GRECO, në raportin final të miratuar. Në punimet plenare u zgjodh anëtar i ri i Byrosë së GRECO, përfaqësues nga Portugalia. Në këto punime, në ditën e 4-t të tyre, Shqipëria informoi GRECO-n për zhvillimet me të fundit të fushës rregulatore, institucionale dhe të dhënave konkrete të luftës kundër korrupsionit, në kuadër edhe të raportimit zyrtar që do të vijojë në muajt pasardhës me vlerësimin që do t'i bëhet vendit në seancën plenare të nëntor-dhjetor 2022. Me rëndësi të veçantë u paraqit ecuria në progresin e politikave dhe nismave parandaluese antikorrupsion, rritja e transparencës për publikun të informacioneve dhe të dhënave për zyrtarët e lartë politikë, deklarimi i pasurive dhe të konfliktit të interesave si dhe mirëfunksionimi i institucioneve ligjzbatuese në vend, në kuadër të stafëve teknike dhe profesionale, si një tregues i përgjigjshmërisë së tyre në luftën kundër korrupsionit.



Grupi Tematik Antikorrupsion, në nivel teknik, dakordëson përmbajtjen e raportit të monitorimit për zbatimin e Planit të Veprimit Antikorrupsion, janar-mars 2022


10.06.2022. Anëtarët e Grupit Tematik Antikorrupsion në nivel teknikë, i përbërë nga përfaqësues të të gjithë institucioneve të përfshira në zbatimin e planit të veprimit antikorrupsion, dakordësuan përmbajtjen e raportit final të monitorimit të planit të veprimit antikorrupsion, për periudhën e parë të zbatimit të tij për vitin 2022, përkatësisht për muajt janar-mars. Ky raport monitorimi, jep një informacion të plotë dhe vlerësues mbi ecurinë e 18 objektivave specifike për të tre qasjet e politikave të parandalimit – ndëshkimit - ndërgjegjësimit kundër korrupsionit, mbështetur plotësisht në të dhënat e zbatimit të masave dhe aktiviteteve të parashikuara për zbatim. Në 3-mujorin e parë 2022, kanë qenë për zbatim 58 masa e 108 aktivitete, nga të cilat 34 masa/64 aktivitete janë realizuar plotësisht, 15 masa/11 aktivitete janë realizuar pjesërisht dhe 9 masa/3 aktivitete nuk janë realizuar. Niveli i zbatimit të Strategjisë Antikorrupsion për këtë periudhë është 78.25% dhe sipas qasjeve është: parandalimi - 86.50 %; ndëshkimi – 81.6 %; ndërgjegjësimi – 66.66 %. Sektorët që kanë shënuar progres në këtë periudhë janë transparencja e autoriteteve publike, digjitalizimi i shërbimeve elektronike, integriteti i nëpunësve publikë në ministritë e linjës, ndërgjegjësimi dhe bashkëpunimi me publikun kundër korrupsionit. Raporti final i monitorimit pritet të diskutohet dhe të miratohet në mbledhjen e Komitetit Koordinator kundër Korrupsionit. Raporti final do të publikohet në faqen e internetit të Ministrisë së Drejtësisë, në të cilën është tashmë i publikuar draft raporti dhe raporti i konsultimit shoqërues i tij.

Këto raporte mund të mund të aksesohen në këtë link: <https://drejtesia.gov.al/viti-2022-2/>

Koordinatori Kombëtar Kundër Korrupsionit lidh marrëveshje bashkëpunimi me Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI)

6.06.2022. Ministri i Drejtësisë në rolin e Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit, z.Manja dhe Kryeinspektori i ILDKPKI, znj. Bashari nënshkruan një marrëveshje bashkëpunimi në luftën kundër korrupsionit në administratën publike. Qëllimi kryesor i marrëveshjes është sigurimi dhe garantimi i koordinimit, bashkëpunimit dhe shkëmbimit të informacionit midis dy institucioneve publike në kuadër të angazhimit të përbashkët, që është lufta kundër korrupsionit. Kjo marrëveshje bashkëpunimi përcakton gjithashtu kuadrin e përgjithshëm rregulator midis Ministrisë së Drejtësisë dhe ILDKPKI, me synimin final përmirësimin e trajtimit të çështjeve dhe arritjen e rezultateve të rëndësishme sa i përket veprimtarive me objekt të përbashkët. Dy institucionet janë autoritete publike që kanë rol kryesor në luftën kundër korrupsionit dhe pasja e një marrëveshjeje bashkëpunimi shtron dhe lehtëson procedurat e komunikimit mes tyre, si një gur themeli dhe garanci në arritjen e qëllimeve të përbashkëta.





Ekspertët qeveritarë shqiptarë marrin pjesë në seancën e vlerësimit të zbatimit të Konventës së OKB, nga Lituania



21-23.06.2022. Shqipëria së bashku me Bullgarinë nën drejtimin e Sekretariatit Teknik të Konventës së Kombeve të Bashkuara Kundër Korrupsionit (UNCAC) zhvilluan vizitën studimore për vlerësimin dhe rishikimin e UNCAC, nga Lituania. Takimi u zhvillua në vijim të hartimit të raportit të vlerësimit për përmbushjen e parashikimeve ligjore, rregullatore dhe të funksionimit të institucioneve në Lituani, prej dy ekipeve të vlerësimit të të dy vendeve. Ekipi i ekspertëve të Shqipërisë përbëhej nga specialistë të fushës antikorruption pranë Ministrisë së Drejtësisë, të Drejtorisë së Parandalimit dhe Pastrimit të Parave dhe të Policisë së Shtetit. Pala shqiptare ishte e angazhuar për të vlerësuar zhvillimet dhe zbatimet e parashikimeve të nenit 14 (masat për parandalimin e pastrimit të parave) dhe kapitulli V (Rekuperimi i Aseteve) të UNCAC, ndërsa ajo e Bullgarisë për kapitullin II (Masat parandaluese). Në takim morrën pjesë përfaqësues të institucioneve vendase të Lituanisë, në fushën e përgjegjësisë së të cilëve ishin për kompetencë kapitujt për vlerësim. Takimi u koordinua nga sekretariati teknik i UNODC dhe u zhvillua në formatin hibrid me përfaqësuesit e palëve.

Ministria e Drejtësisë forcon bashkëpunimin me organizatat e shoqërisë civile, në rritje të integritetit të administratës publike

7- 8.06.2022. Ministria e Drejtësisë në rolin e institucionit lider në hartimin dhe zbatimin e politikave antikorruption morri pjesë në konferencën rajonale të zhvilluar në Tiranë nga Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim: *Nxitja e reformave të qëndrueshme dhe me integritet në administratat publike të Ballkanit Perëndimor*. Zëvendësministri i Drejtësisë, znj. Pirdeni ishte pjesë e panelit të ditës së dytë të konferencës, në të cilën u ndanë dhe informuan të dhëna për instrumentet e luftës kundër korrupsionit, siç përmenden planet e integritetit dhe iniciativa ndërgjegjësuese dhe publike që rrisin informacionin dhe bashkërendojnë veprimet me qytetarët në luftë kundër korrupsionit. Administrata publike në nivel qendror ka tashmë plane integriteti të miratuara dhe në zbatim, një mënyrë më e mirë dhe e sigurtë kontrolli e rritjes së performancës dhe llogaridhënies së administratës publike në luftë kundër korrupsionit. Përmes raporteve të vjetore të monitorimit të tyre, do të krijohen garanci të qëndrueshme për zbatimin e planeve dhe zhvillimin e përgjithshëm të integritetit në administratën shtetërore, si një mënyrë shumë me efikse dhe e duhur në marrjen e nismave se ku duhet ndërhyrë më mirë në kuadrin e politikave dhe derregullimit.



Gender dhe antikorruptioni, bashkë për politika më të mira dhe gjithëpërfshirje



30.06.2022-1.07.2022. Filloi në datën 30 qershor 2022, në Tiranë trajnimi dy-ditor për hartimin e politikave *gender* dhe antikorruption. Prezenca e OSBE në Shqipëri, në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë organizoi një tryezë-trajnim, me temë: *Integrimi gjinor në nismat kundër korrupsionit*. Kjo veprimtari u zhvillua me qëllim forcimin e kapaciteteve të pikave fokale antikorruption dhe rritjen e ndërgjegjësisë publike lidhur me këtë çështje madhore. Takimin e përshëndeti këshilltarja e lartë për çështjet gjinore të Sekretariatit të OSBE-së znj. Lara Scarpitta, Zëvendësministri i Drejtësisë znj. Pirdeni, Zëvendësministri i Shëndetësisë dhe të Mbrojtjes Sociale znj. Seferi. Partnerë ndërkombëtarë të fushës si UN Women, Delegacioni i Bashkimit Evropian në Shqipëri dhe ambasada e Vendeve të Ulëta ishin të pranishëm gjithashtu. Diskutimi u fokusua mbi mënyrat sesi të aplikohet analiza gjinore dhe instrumentet e integritetit gjinor në politikat dhe qasjet kundër korrupsionit. Ministria e Drejtësisë në rolin e saj udhëheqës të hartimit të politikave dhe nismave antikorruption dhe në drejtim të institucioneve zbatuese të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër korrupsionit (rrjeti i pikave të kontaktit antikorruption) morrën dhe shkëmbyen informacione për përfshirjen e *gender* dhe të orientimit të këtyre iniciativave në këtë fushë. Strategjia e re antikorruption do të ketë një objektiv të veçantë për politikat *gender*.

Stafi antikorruption i Ministrisë së Drejtësisë trajnim për prokurimin publik

9.06.2022. Stafi teknik i Drejtorisë Operacionale Antikorruption dhe të Drejtorisë së Monitorimit të Rrjetit Antikorruption në Ministrinë e Drejtësisë morrën pjesë në një trajnim një-ditor për çështje të prokurimit publik, përkatësisht për ndjekje, verifikim dhe hetim të procedurave të prokurimit publik si një prej sektorëve që janë më të prekshëm nga korrupsioni. Trajnimi u mundësua nga Ambasada e Francës në Tiranë në bashkëpunim me ekspertë të fushës, të Agjencisë së Prokurimit Publik. Specialistët e dy drejtorive që trajtojnë dhe hetojnë raste denoncimesh për korrupsion në Ministrinë e Drejtësisë morrën njohuritë më të fundit për teknikat e hetimit dhe të verifikimit antikorruption, kontrole të autoriteteve



publike që merren me procedurat e prokurimit publik, vlerësimin e riskut që paraqet sektori si dhe administrimin e procedurave për të siguruar një parandalim të mirë dhe kontroll të tyre. Ministria e Drejtësisë ka rakorduar dhe rritur bashkëpunimin me shumë partnerë të fushës, duke mundësuar ofrimin e njohurive dhe të mundësive të trajnimit të vazhdueshëm për stafin e saj.



Të rinjtë në luftën kundër korrupsionit; finalet e Kampionatit Kombëtar të Debatit: Korrupsioni pasiv dhe aktiv



30.06.2022. Është përmbyllur me sukses aktiviteti rinor, Kampioni Kombëtar i Debatit, i organizuar nga Liburnetik. Edicioni i 5-të i këtij aktiviteti, ka pasur në fokus temën e luftës kundër korrupsionit. Të rinjtë dhe nxënësit e shkollave të mesme nga i gjithë vendi morrën pjesë për disa muaj në debatet publike mes ekipeve të shkollave, për çështje që shqetësojnë shoqërinë. 1500 nxënës gjimnazistë dhe 100 mësues të shkollave kanë ndjekur dhe marrë pjesë aktive në seanca «debatit» të simuluar, që nxisin të mënduarin kritik dhe analitik. Në finalet e këtij kampionati debati morrën pjesë shkollat e mesme «Ibrahim Kodra», «Protagonistët», «Harry T. Fultz» dhe «Naim Frashëri», ku shkolla «Harry T. Fultz» në Tiranë arriti të triumfojë. Në debatin final, u fol gjithashtu për çështje si arsimit, mjedisi por edhe politikat dhe angazhimi qytetar. Të pranishëm në këtë aktivitet ishin zyrtarë të lartë të fushës së antikorrupsionit në Ministrinë e Drejtësisë, të fushës së Arsimit dhe të mbrojtjes së të drejtave të të rinjve.

